



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-400/04-0017297-2/dt. 27-03-2021
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenet 9 dhe 38 të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, dhe pas shqyrtimit të Propozim-Vendimit të Drejtorisë për Shëndetësi Nr. 01-400/04-0017297/25, dt. 21.03.2025, të nxjerrë në bazë të Raport - Rekomandimit Nr. 10-400/04-0017296/25, dt. 21.03.2025, të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet** Propozim-Vendimi i Drejtorisë për Shëndetësi Nr. 01-400/04-0017297/25, dt. 21.03.2025, dhe i lejohet shfrytëzimi i mjeteve financiare nga buxheti i Komunës së Mitrovicës në shumë totale prej 21,820.00 € (njëzet e një mijë e tetëqind e njëzetë euro) si në Rekomandimin Nr. 10-400/04-0017296/25, dt. 21.03.2025, të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ndarjen e subvencioneve të kësaj drejtorie.
2. Mjetet financiare sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi lejohen me qëllim të përkrahjes për rastet emergjente për tretmën mjekësor për banorët e Mitrovicës së Jugut. Pas shqyrtimit të kërkesave të paraqitura, adresuar kësaj Drejtorie, dhe Rekomandimit të nxjerr nga Komisioni i Drejtorisë, përfitues të përkrahjes financiare janë gjithsej 217 (dyqind e shtatëmbëdhjetë) persona.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Rekomandimi i nxjerrë nga Komisioni i Drejtorisë për Shëndetësi Nr. 10-400/04-0017296/25, dt. 21.03.2025, në bazë të të cilit do të bëhet ekzekutimi i mjeteve financiare.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Shëndetësi në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, ndërsa mjetet e parapara sipas këtij Vendimi paguhen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe Transfere të Drejtorisë së Shëndetësi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim


Drejtorja për Shëndetësi me Propozim-Vendimin Nr. 01-400/04-0017297/25, dt. 21.03.2025, ka kërkuar lejin e mjeteve financiare nga pozicioni i subvencioneve të kësaj drejtorie, me arsyetimin se me planin e punës së drejtorisë është paraparë subvencionimi i qytetarëve të Mitrovicës së Jugut me sëmundje të rënda, e që kanë nevojë për trajtimin mjekësor dhe që shpenzimet nuk mund t'i përballojnë.

Komisioni ka shqyrtuar kërkesat e paraqitura në këtë Drejtori dhe ka raportuar për rastet që i plotësojnë kriteret për përfitimin e subvencioneve nga kjo drejtori, gjithsej 217 (dyqind e shtatëmbëdhjetë) persona, si dhe kërkesat të cilat janë refuzuar, gjithsej 212 (dyqind e dymbëdhjetë), kërkesa të cilat nuk i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret sipas Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve.

Kryetari i Komunës pasi e shqyrtoi Propozim-Vendimin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe e trajtoi atë të arsyeshëm vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Kryetari i Komunës


Bedri HAMZA

Shtojcë:

Propozim - Vendimi i Drejtorisë së Shëndetësi Nr. 01-400/04-0017297/25, dt. 21.03.2025;
Raporti i Komisionit për rastet e rekomanduara Nr. 10-400/04-0017296/25, dt. 21.03.2025.

T'i dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Drejtorisë së Shëndetësisë
- 1x1 Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- 1x1 Arkivit

